

RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR

Për auditimin ligjor të fondeve të përftuara dhe të shpenzuara
Për vitin kalendarik 2011

“PARTIA E INTEGRIMIT SOCIAL KOMBËTAR SHQIPTAR”

Rr. Artan LENJA, Fusha Helikoptereve, H – 25/1, Tiranë

Komisionit Qendror të zgjedhjeve

Shoqëria “FICADEX ALBANIA” u angazhua për auditimin e fondeve të përftuara dhe të shpenzuara nga Partia Politike “PARTIA E INTEGRIMIT SOCIAL KOMBËTAR SHQIPTAR” për vitin kalendarik 2011”.

Përgjegjësia e drejtimit për përgatitjen e pasqyrave financiare

Partia “PARTIA E INTEGRIMIT SOCIAL KOMBËTAR SHQIPTAR” ka përgjegjësi të përgatisi pasqyrat financiare për fondet e përftuara dhe të shpenzuara që përbëhen nga bilanci kontabël për vitin kalendarik që përfundon me 31/12/2011, pasqyrën e fondeve të përftuara dhe shpenzuara, e cila tregon të ndara fondet e përftuara nga kuotat e anëtarësisë, subvencione shtetërore, ndihma dhe fonde nga burime të tjera, si dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe shënimeve të tjera anekse në përputhje me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 (i ndryshuar) “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” si dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe në zbatim të tij. Kjo përgjegjësi përfshin: hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm të përshtatshëm mbi përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi; zgjedhjen dhe zbatimin e metodave të përshtatshme kontabël ; dhe kryerjen e çmuarjeve kontabël të arsyeshme për rrethanat

Për shkaqet që janë përshkruar në paragrafin “Bazat për refuzimin e dhënies së opinionit” ne nuk e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (standardi nr. 800, “Raporti i audituesit mbi angazhimet e auditimit për qellime të veçanta”). Këto standarde kërkojnë që ne të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arësyeshme që pasqyrat financiare për fondet e përftuara dhe shpenzuara gjatë vitit kalendarik 2011 të jenë pa anomali materiale. Auditimi ynë përfshin shqyrtimin, mbi bazën e testeve, të fakteve që mbështesin shumat dhe deklaratimet në pasqyrën financiare; vlerësimin e parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësime të rëndësishme të bëra nga drejtimi i Partisë; si dhe vlerësim të paraqitjes së përgjithshme të pasqyrës.

Bazat për refuzimin e dhënies së opinionit

- 1) Ne nuk na u vunë në dispozicion Pasqyrat Financiare për fondet e përftuara dhe të shpenzuara që përbëhen nga bilanci kontabël për vitin kalendarik që përfundon me 31/12/2011, pasqyra e fondeve të përftuara dhe shpenzuara, e cila tregon të ndara fondet e përftuara nga kuotat e anëtarësisë; subvencione shtetërore; ndihma dhe fonde nga burime të tjera; si dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe shënimeve të tjera anekse dhe dokumentacioni përkatës mbi bazën e të cilit janë përgatitur këto pasqyra;
- 2) Informacioni i siguruar nga KQZ; Dega Rajonale e Tatimeve Tiranë; Interneti; Gjykata e Regjistrimit të rrethit Tiranë dhe informacione nga burime të tjera, nuk na mundësoi identifikimin e fondeve të përftuara dhe të shpenzuara nga Partia Politike “PARTIA E INTEGRIMIT SOCIAL KOMBËTAR SHQIPTAR”.

RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR

Për auditimin ligjor të fondeve të përftuara dhe të shpenzuara
Për vitin kalendarik 2011

Refuzim për të dhënë opinion

Për shkak të kufizimeve të rëndësishme siç janë përshkruar në paragrafin “Bazat për refuzimin e dhënies së opinionit”, nuk na u mundësua marrja e evidencës së auditimit të mjaftueshme dhe të përshtatëshme për të dhënë opinionin tonë. Për këtë arsye ne nuk mund të shprehim opinion mbi fondet e përftuara dhe të shpenzuara të Partisë “PARTIA E INTEGRIMIT SOCIAL KOMBËTAR SHQIPTAR”.

Kufizimi i shpërndarjes dhe përdorimit të raportit

Pa modifikuar opinionin tonë, tërheqim vëmendjen se raporti ynë audit jepet vetëm për informim dhe përdorim nga KQZ dhe manaxhimi i partisë “P.I.S.K.SH”. Si rezultat, ai nuk mund të përdoret për ndonjë qëllim tjetër.

Data 19/06/2012



Marije DUSHI - Senior Auditor

L. 4, Rr. Migjeni, Durrës